



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 3697 Prot

Lezhë, më 25. 03. 2024

V E N D I M

Nr. 85, Datë 25. 03. 2024

Për një ndryshim në Buxhetin e vitit 2024, në Programin Buxhetor AG127

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

V E N D O S A :

1.Për një ndryshim në Buxhetin e vitit 2024, në Programin Buxhetor AG127 “Përkujdesja Sociale dhe Strehimi”, Funkcionin “10430”, Produkti V043AAC, si më poshtë:

- Paksohen shpenzimet në:

-Gr.00, Prog.AG127, Funk.“10430”, Produkti V043AAC, Kap.05, Art.231 në shumën 1,875,312 lekë, me emërtim: “Mobilim çerdhe (detyrim i vitit 2023)”.

- Shtohen shpenzimet në:

-Gr.00, Prog.AG127, Funk.“10430”, Produkti V043AAC, Kap.05, Art.231 gjithsej në shumën 1,875,312 lekë, me emërtim: “Blerje pajisje dhe makineri për çerdhen”, konkretisht: Aspirator profesional me tuba aspirimi për kuzhinën në shumën 96,000 lekë, Veshje kolonash me tapiceri në shumën 28,800 lekë, Zgara hekuri për dritaret e godinës së çerdhes në shumën 940,992 lekë, Zgara hekuri për dyert e jashtme të godinës së çerdhes në shumën 102,000 lekë, Tenda elektrike me kolona për karrocet e fëmijëve në shumën 489,600 lekë, Stola druri për koridoret e brendshëm në shumën 72,000 lekë, Stola hekuri në ambjentet e jashtme në shumën 96,000 lekë, Stendina plastike për rroba në shumën 9,600 lekë dhe Karrike personeli me tapiceri në shumën 40,320 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Njësia e Prokurimit.

3.Ky vendim hyn fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pjetër Ndreu

